

VENDIM
Nr. 46, datë 27.2.2025

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 221, DATË 23.10.2024,
“MBI KËRKESËN E SHOQËRISË ‘ALBESP TRADING & CONSULTING’ SHPK PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SAJ”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1026/2 prot., datë 25.2.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 221, datë 23.10.2024, mbi kërkesën e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 221, datë 23.10.2024 ka vendosur dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. me kushtin që brenda datës 31.12.2024 të depozitojë marrëveshjen/kontratën për shitjen e kuotave dhe ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i ndryshimit të ortakut që kontrollon interesat e saj.

- ERE, me shkresat me nr. 1628/9 prot., datë 15.11.2024, nr. 1628/10 prot., datë 5.12.2024, dhe me e-mailin nr. 1026 prot., datë 7.2.2025 njoftoi dhe solli në vëmendje të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për detyrimet e saj lidhur me autorizimin e ndryshimit të ortakut për plotësimin e kushteve të vendimit.

- Shoqëria, me shkresën nr. 1064 prot., datë 10.2.2025, ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar ku është reflektuar ndryshimi i ortakut që kontrollon interesat e saj. Gjithashtu, me shkresën nr. 1026/1 prot., datë 13.2.2025, shoqëria ka depozituar marrëveshjen/kontratën me nr. repertori. 3472 dhe nr. koleksioni 1447 të datës 9.5.2024, për shitjen e kuotave të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. nga z. Klodian Melëngu te znj. Eni Hasanbelliu e cila bëhet zotëruese me 51% të kapitalit të shoqërisë.

- Me depozitimin e dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se shoqëria disponon marrëveshjen/kontratën për shitjen e kuotave si dhe ekstraktin historik të regjistrit tregtar në të cilën është reflektuar ndryshimi i ortakut që kontrollon interesat e saj. Si e tillë vlerësohet që pikat 4 dhe 5 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 221., datë 23.10.2024, të shfuqizohen. Me shfuqizimin e pikave 4 dhe 5 të vendimit nr. 221/2024, nuk gjen më zbatim as pika 6 e këtij vendimi ndaj vlerësohet dhe shfuqizimi i saj.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, i cili duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 4, 5 dhe 6, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 221, datë 23.10.2024, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti